

## Hapet thirrja për bursa studimi për studentët e UMT, në Universitetin Kodolányi János në Hungari, në kuadër të programit Erasmus +.

### Mobiliteti dhe kohëzgjatja e bursave:

Studentët do të studiojnë semestrin e dytë të vitit akademik 2025-2026 në universitetin Kodolányi János, Hungari.

### Kush mund të aplikojë:

Mund të aplikojnë studentët e UMT të cilët gjatë vitit akademik 2025 -2026 do të jenë në vitin e dytë dhe të tretë, të ciklit bachelor si edhe studentët e vitit të parë dhe të dytë master, në:

- Fakultetin e Ekonomisë
  - BSc në Administrim Biznesi.
  - Program profesional 2-vjeçar në Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente.

Lëndët të cilat zhvillohen në anglisht në universitetin pritës në semestrin e parë i gjeni duke klikuar në linkun: <https://www.kodolanyi.hu/en/erasmus>

### Gjuha e mësimdhënies:

Mësimdhënia do të jetë në gjuhën angleze.

### Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor për studentët (800 EUR në muaj);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës).

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni në këtë link:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

### Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Kopje e pasaportës
- Listë notash të ciklit aktual të studimit;
- Fotokopje e Certifikatës/dëshmi e gjuhës angleze ose dokument që vërteton njohuritë në këtë gjuhë. Niveli i kërkuar B2; Nqs mungon certifikata e njohur ndërkombëtarisht atëherë pajisuni me një certifikatë nga lektori i gjuhës angleze në UMT.
- Learning Agreement\*

*\* Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të*

*merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin Metropolitan Tirana kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Kodolányi János, Hungari lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e dytë të vitit akademik 2025/2026 në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të jepni provim lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Metropolitan Tirana.*

*Dokumenti "Learning Agreement" tek seksioni "Commitment" firmoset nga aplikanti dhe më pas në seksionin "sending university" firmoset nga Përgjegjësi i Departamentit në UMT.*

Për më shumë informacion rreth aplikimit tuaj në Universitetin Kodolányi János në Hungari, lutemi klikoni këtu: <https://www.kodolanyi.hu/en/erasmus/spring-semester>

Afati për aplikim: **14 Nentor, 2025.**

Për të aplikuar ju lutemi dergoni ne e-mail në adresën iro- projects@umt.edu.al.

***UMT ju uron shumë suksese në aplikimin tuaj!***